




Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Juzna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

KUVENDI I KOMUNËS SË MITROVICËS SË JUGUT
Nr. 02-060/01- 0039827/20-12 dt. 22.07.2020
Mitrovicë



Plani Komunal i punës për arritjen e barazisë gjinore 2020-2023, Mitrovicë

Korrik, 2020

Përmbajtja

Hyrje përmbledhëse	3
Qëllimi dhe objektivat e planit të komunal të punës	4
Legjislacioni vendor dhe ndërkombëtar	5
Instrumentet kryesore Ndërkombëtare për Barazi Gjinore dhe Fuqizimin e Grave.....	6
Korniza ligjore dhe politikat vendore për Barazi Gjinore dhe Fuqizimin e Grave.....	7
Korniza zhvillimore vendore dhe veprimet për promovimin e Barazisë Gjinore dhe fuqizimin e Grave.....	7
Problemet e identifikuar deri tani që kanë shkaktuar pabarazinë gjinore në komunën e Mitrovicës	8
Fushat në të cilat ka fokus ky plan pune	9
Kohëzgjatja e zbatimit të planit të punës dhe institucionet e përfshira.....	10
..	
Aktivitetet për zbatim.....	11
Plani i monitorimit dhe i vleresimit	13
Tabela e veprimeve	14

I Hyrje përmbledhëse

Barazia gjinore është një e drejtë themelore e përcaktuar si një parim fundamental në Kushtetutën e Republikës së Kosovës ,barazia gjinore konsiderohet faktorë i rëndësishëm për rritje dhe zhvillim ekonomik, mirëqenje sociale dhe stabilitet. Përkushtimi për barazi gjinore thekson domosdoshmërinë për zhvillimin dhe zbatimin e politikave, përmes strategjive dhe programeve, kornizës ligjore, dhe ofrimin e të mirave dhe shërbimeve për të arritur qëllimin e përcaktuar për barazi gjinore.

Arritja e barazisë gjinore e paraparë edhe me Ligjin për Barazi Gjinore nr 05/L-020 kërkon angazhim të strukturave të ndryshme publike dhe private për të diskutuar dhe zgjidhur çështjet e ndryshme si ato të arsimit ,shëndetit ,shërbimeve sociale punësimit, drejtësisë ,familjes, fëmijëve dhe të moshuarve etj.

Me qëllim të parandalimit dhe eliminimit të diskriminimit gjinor dhe arritjes së barazisë gjinore, institucionet e Republikës së Kosovës të të gjitha nivele të pushtetit ligjëvënës ekzekutiv gjyqësor dhe institucionet e tjera publike janë përgjegjëse për të zbatuar masat legjislative si dhe masat tjera duke përfshirë edhe miratimin e strategjive dhe planeve të veprimit për promovimin dhe vendosjen e barazisë gjinore në përputhje me Programin e Kosovës për Barazi Gjinore 2020 -2024 , i miratuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës me datën 23. maj 2020 nr vendimit 01/34 .

Të gjitha institucionet e të gjitha niveleve kanë detyrim në zbatimin e këtij programi , prandaj është edhe detyrim që të kenë plane të punës në të cilat do të specifikojnë aktivitetet me qëllim të realizimit të objektivave qendrore.

Ky dokument synon të japë ndihmesën në arritjen e standardeve më të larta në trajtimin e barazisë gjinore.

Ky plan pune i referohet implementimit si dhe zbatimit të kuadrit ligjor për barazi gjinore në tërësi si dhe akteve tjera nënligjore dhe politikave publike për barazi gjinore .

II Qëllimi dhe objektivat e planit komunal të punës

Gjendja aktuale në Kosovë në përgjithësi po edhe në Komunën e Mitrovicës në vecanti nuk është e kënaqshme dhe një ndër problemet kryesore është prania e pabarazive dhe përjashtimi socio-ekonomiko-strukturor. Faktorët kryesorë që ndikojnë në këtë problem janë: mungesa e integrimit gjinor në strategji dhe politikat zhvillimore; mos zbatimi i buxhetimit të përgjegjshëm gjinor; diskriminimi në punësim; niveli i ulët i shkollimit të grave në moshë pune (15-64); ndarja e profesioneve sipas gjinisë; ndarja e pabarabartë e obligimeve për përkujdesjen e fëmijëve dhe të moshuarve; mungesa e institucioneve për përkujdesjen e fëmijëve; dhe qasja e kufizuar në të drejtat pronësore dhe financa.

Probleme tjera të identifikuar janë pabarazia dhe përjashtimi strukturor në arsim, dhe mos shfrytëzimi adekuat i kapaciteteve njerëzore në fusha të ndryshme të jetës socio-kulturore dhe institucionale, prania e stereotipeve gjinore mbi ndarjen e punës, pjesëmarrje e ulët e grave në pozita vendimmarrëse dhe ri integrimi të viktimave të dhunës në familje.

Komuna e Mitrovicës do të sigurojë që barazia gjinore do të jetë e garantuar në kuadër të të gjitha strukturave, institucioneve, politikave, procedurave, praktikave dhe programeve të Komunës dhe do të ndërmarrë këtë iniciativë si obligimin i dalë nga legjislacioni vendor dhe ndërkombëtar për arritjen e barazisë gjinore me të cilën synon

- Krijimin e mundësive të barabarta në pjesëmarrje dhe përfitim ekonomik dhe përmirësimin e mirëqenies sociale;
- Avancimin e barazisë gjinore, dhe zhdukjen e pabarazive dhe stereotipeve gjinore;
- Avancimin e realizimit të të drejtave në vendimmarrje

III Legjislacioni vendor dhe ndërkombëtar

Hartimi i Planit të punës për arritjen e barazisë gjinore të Komunës së Mitrovicë është obligim që del nga Ligji për Barazi Gjinore 05/L -020 specifikisht, Neni 5 , paragrafi 1.2 i cili obligon institucionet e Republikës së Kosovës të miratojnë strategji dhe plane të veprimit për promovimin dhe vendosjen e barazisë gjinore.

për më tepër ky ligj në paragrafin 1.3 obligon institucionet të përfshijnë integrimin gjinor në të gjitha politikat, dokumentet dhe legjislacion ,

sigurimin e barazisë gjinore në proceset e përzgjedhjes dhe caktimit në punë duke përfshirë pozicionet drejtuese duke siguruar përfaqësim të barabartë edhe në konferenca mbledhje dhe trajnime dhe duke siguruar burime të përshtatshme njerëzore dhe financiare për programe,projekte dhe iniciativa per arritjen e barazise gjinore

ligji gjithashtu obligon institucionet edhe për mbledhjen e të dhënave sipas gjinisë dhe shpërndarjen e tyre

institucionet publike ndërmarrin masa të vecanta të përkohshme me qëllim të arritjes së dhe realizimit të barazisë faktike midis femrave dhe meshkujve në fushat ku ekzistojnë pabarazi .

Ky Plan veprimi është hartuar duke konsideruar instrumentet, kornizën ligjore dhe politikat kryesore ndërkombëtare dhe kombëtare për sigurimin e barazisë gjinore dhe fuqizimin ekonomik të grave, më kryesoret janë të prezantuara në vijim.

Ligji për Barazi Gjinore Nr. 05/L -020 obligon institucionet e Kosovës të sigurojnë që të gjitha politikat, duke përfshirë buxhetet, të përfshijnë analizën gjinore. “Kjo do të thotë se organizatat buxhetore duhet të kryejnë analiza gjinore për të vlerësuar shkallën në të cilën programet e tyre i kanë plotësuar nevojat e grave, burimeve, djemve dhe vajzave ndryshe në të kaluarën, dhe për ta përdorur këtë informacion më pas për ta përfshirë në planifikimin buxhetor për të ardhmen.”

Krahas dispozitave tjera **Neni 21**, i Ligjit për Barazi Gjinore, cekë: Në shkolla dhe institucione të tjera arsimore mjetet mësimore të përdorura duhet të bazohen në barazinë gjinore dhe edukimin për barazinë gjinore duhet përfshirë në kurrikulat shkollore në të gjitha nivelet. 2. Përgatitja, miratimi dhe zbatimi i programit arsimor - edukativ, hartimit të materialeve, teksteve shkollore dhe rishikimit të materialeve dhe teksteve ekzistuese duhet të bëhet me përfshirjen e perspektives gjinore dhe eliminimin e stereotipeve

negative, paragjytimeve, praktikave zakonore dhe praktikave tjera, që janë në kundërshtim me parimin e barazisë gjinore. 3. Përfshirja në programet e shkollave aktivitete edukative dhe trajnuese që synojnë sensibilizimin

Neni 6 i Ligjit për Barazi Gjinore parasheh qartë se *“Përfaqësimi i barabartë gjinor në të gjitha organet legjislative, ekzekutive dhe gjyqësore dhe institucionet e tjera publike arrihet kur sigurohet përfaqësim minimal prej pesëdhjetë % (50%) për secilën gjini, përfshirë edhe organet e tyre drejtuese dhe vendimmarrëse*

Instrumentet kryesore Ndërkombëtare për Barazi Gjinore dhe Fuqizimin e Grave

- Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut,
- Konventa për të Drejtat Politike të Grave,
- Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Ekonomike, Shoqërore dhe Kulturore,
- Konventa për Eliminimin e të gjitha formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW),
- Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijëve,
- Deklarata e Pekinit dhe Platforma e Veprimit të vitit 1995,
- Strategjia Zhvillimore e Vendi 2016-2020,
- Konventa e Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftën Kundër Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje-Konventa e Stambollit, 2011
- Rezoluta 1325 dhe 1820 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara mbi Gratë, Paqen dhe Sigurinë ,
- Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut
- Agjenda e Synimeve për Zhvillim të Qëndrueshëm e kombeve të Bashkuara 2030
- Deklarata e KB për Eliminimin e Dhunës ndaj Grave .

Korniza ligjore dhe politikat vendore për Barazi Gjinore dhe Fuqizimin e Grave

- Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Neni 7, 21 dhe 22
- Ligji për barazi Gjinore Nr. 05/L-020
- Ligji për Mbrojtje nga Dhuna në familje Nr. 03/L-182
- Ligji për Trashëgimi Nr.2004/26

- Ligji i Familjes Nr.2004/32
- Ligji për Mbrojtje nga Diskriminimi.05/L-021
- Ligji për Pronat dhe të Drejtat Pronësore Nr.03/L-154
- Ligji i Punës Nr. 03/L-212

Korniza zhvillimore vendore dhe veprimet për promovimin e Barazisë Gjinore dhe fuqizimin e Grave:

- Programi i Kosovës për Barazi Gjinore,
- Strategjia Kombëtare për Zhvillim,
- Programi i Reformave Ekonomike,
- Strategjia për Rregullim më të Mirë,
- Strategjia Nacionale dhe Plani i veprimit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje,

Parimet kryesore të cilat janë marrë parasysh në hartimin e këtij plani janë:

- ✓ Të drejtat e grave janë dhe të drejtat e njeriut,
- ✓ Barazia gjinore është kontribues I rëndësishëm për zhvillim të qëndrueshëm të vendit,
- ✓ komuna duhet të posedojnë kapacitete për të integruar barazinë gjinore dhe avancuar fuqizimin e grave,

IV Problemet e identifikuara deri tani që kanë shkaktuar pabarazinë gjinore në Komunën e Mitrovicës

Problemi kryesor në fushën e fuqizimit ekonomik dhe mirëqenies sociale është *prania e pabarazive dhe përjashtimi socio-ekonomiko*. Ky problem shkaktohet nga një mori faktorësh, të diskutuar në vijim.

- **Mungesa e integritit gjinor në strategji dhe politikat zhvillimore.**
- **Duke mos qenë të përfaqësuara në proceset vendimmarrëse, kërkesat dhe nevojat e tyre specifike nuk merren parasysh,** investohet më pak në përmirësimin e kushteve që ndihmojnë gratë (për shembull në rrugë lokale dhe furnizim me ujë) dhe në sektorët me potencial për punësimin e grave (siç është turizmi dhe disa degë të bujqësisë).
- **Në mungesë të institucioneve për *përkujdesjen e fëmijëve deri në moshën 5 vjeçare*, posaçërisht për gratë që jetojnë në fshatra, gratë detyrohen të qëndrojnë në shtëpi.** Mungesa e institucioneve për kujdesjen e fëmijëve pas mësimit, paraqitet si pengesë, posaçërisht për familjet me të ardhura të ulëta, që nuk kanë mundësi të përballojnë koston në institucione private.
- **Mungesa e raportimit dhe analizës së statistikave nga perspektiva gjinore, në përputhje me kërkesat e Ligjit për Barazi Gjinore, mbetet sfidë në Kosovë.** Institucionet e Kosovës vazhdojnë ndër vite të sfidohen me mungesën e raportimit dhe analizës së statistikave nga perspektiva gjinore
- **Diskriminimi gjinor** evidentohet në punësim dhe avancimin profesional, mungesa e infrastrukturës (specifikisht institucioneve parashkollore, transportit) dhe e sigurisë (dhuna në shkollë, ngacmimi seksual) i kontribuon pozitës së marginalizuar të vajzave dhe grave (braktisje e shkollimit, mungesë e shkathtësive për punë, varësi ekonomike); dhe arsim formal profesional që reflekton stereotipat ekzistuese gjinore mbi ndarjen e punës dhe nuk përmban zgjedhje për marginalizimin e vajzave dhe grave në tregun e punës.

V Fushat në të cilat ka fokusin ky Plan i Punës

Fusha A e veprimit

Fuqizimi ekonomik

Objektivi 1 Krijimi i mundësive të barabarta për të kontribuar dhe përfituar nga zhvillimi ekonomik gjithëpërfshirës dhe përmirësimin e mirëqenies sociale . Ky objektivi ka për qëllim të siguroj ,avancoj fuqizimin ekonomik dhe përmirësim të mirëqenies sociale të grave, rrit aktivizimin e grave në tregun e punës dhe r shkallën e punësimit të tyre gjithashtu te siguroje që gratë kanë qasje të barabartë në të drejta, burime dhe shërbime.

Fusha B e veprimit

Avancimi i barazise gjinore

Objektivi 2 Avancimin e barazisë gjinore, dhe zhdukjen e pabarazive dhe stereotipeve gjinore .

Ky objektivi synon të kontribuoj në avancimin e barazisë gjinore duke theksuar të drejtën themelore për mundësi të papenguar në realizimin e kapaciteteve dhe potencialeve të vajzave dhe grave, eliminimin e praktikave diskriminuese shoqërore (në bazë të gjinisë, etnisë, moshës, dhe aftësisë) dhe krijimin e politikave të cilat përkrahin dhe avancojnë pjesëmarrje të barabartë të grupeve të marginalizuara

Fusha C e veprimit

Vendimarrja

Objektivi 3 Avancimi i realizimit të të drejtave në vendimmarrje, Avancimin e realizimit të të drejtave në vendimmarrje garantues i arritjes së barazisë gjinore

Ky objektivi ka për qëllim të siguroj, përmirësoj dhe rris vendimmarrjen duke promovuar specifikiisht barazinë gjinore dhe integruar perspektivën gjinore në politika komunale, fuqizuar mekanizmat institucional për barazi gjinore.

VI. Kohëzgjatja e zbatimit të planit dhe institucionet e përfshira

Kohëzgjatja e planit të punës është i paraparë si plan që do të zbatohet në periudhën 3 vjecare 2020-2022

Institucionet zbatuese dhe partnere

Institucioni kryesor zbatues për këtë plan veprimi është Komuna e Mitrovicës me dikasterët e saj si dhe Zyra për Barazi gjinore në kuadër të kësaj Komune, këto organe kanë për detyrë që të promovojnë mundësi të barabarta për të gjithë pa marrë parasysh përkatësinë gjinore fetare etnike moshë e racë ti promovojë vlerat për të drejtat e njeriut si dhe të kujdeset për zbatimin e standardeve dhe raportimin mbi realizimin e tyre ,

Të gjitha aktivitetet do të mbështeten nga grupi i grave asambleiste në kuadër të Kuvendit Komunal të kësaj Komune

Ndër institucionet e tjera të përfshira në zbatimin e elementeve të caktuara të këtij plani janë

Institucionet e nivelit qendror si Agjencia për Barazi Gjinore në Zyren e Kryeministrit përmes Zyrtares për Barazi Gjinore në Komunë , qendrat për punë sociale , shkollat, zyrat për punësim ,organizatat joqeveritare dhe persona tjerë juridik që veprojnë në Komunën e Mitrovicës.

VII Aktivitetet për zbatim

Arritja e objektivave të parapara në këtë plan kryhet përmes zbërthimit të tyre në aktivitetet përkatëse të cilat janë renditur sipas shtyllave të përcaktuara në planin kombëtar për barazi gjinore dhe gjithashtu kanë edhe afatin kohor mbrenda të cilës do të duhet të përfundojnë.

Objektivat specifike dhe disa prej aktiviteteve të planifikuara në Planin e Veprimit renditen si me poshtë

Fuqizimi ekonomik

Objektivi 1 Krijimi i mundësive të barabarta për të kontribuar dhe përfituar nga zhvillimi ekonomik gjithëpërfshirës dhe përmirësimin e mirëqenies sociale

- Aktivitete promovuese për të drejtat në punë dhe pushimi i lehonisë (fushata vetëdijësuese dhe kampanja informuese për publikun e gjerë me theks të vecant gratë te cilat janë te gatshme për punë ,këtu mund të hyjnë edhe trajnimet dhe sesionet informuese)
- Subvencionimi i pagesës për kopshtet e fëmijëve të nënave vetë-ushqyese, përfituese të skemave sociale
- Analiza dhe vlerësimi i kostos financiare për subvencionimin e pagesës për edukimin parashkollor, për fëmijët nga familjet që janë në skema sociale
- Trajnimi i përfituesve të kategorive sociale dhe angazhimi i tyre në programet e punësimit
- Përmisimi i shërbimeve që ofrohen në qendrat rezidenciale dhe ditore për personat e moshuar dhe pa përkujdesje familjare
- Ndërmarrja e masave afirmative në punësim
- Ngritja e kapaciteteve për reingrimin gjinor në politika publike, në nivelin lokal
- Monitorimi i politikave komunale me qëllim të përfshirjes së prespektivës gjinore .
- Integrimi i prespektives gjinore / marrja e masave afirmative (masa afirmative per ndarjen e banesave sociale)
- Promovimi i grave të suksesshme në profesione jotipike si bujqesi,ndermarresi,shembujt ne kooperativa etj
- Përfshirja e prespektivës gjinore në panairret ekzistuese
- Informimi i grave për mundësitë e përfitimit nga programet Komunale
- Organizimi i punëtorive nje ditore me gratë e interesuara për të filluar bisnese

Avancimi i barazisë gjinore

Objektivi 2: Avancimin e barazisë gjinore dhe zhdukjen e pabarazive dhe stereotipeve gjinore

Aktivitete

- Aktivitete vetëdijësuese për nevoja per arsimimin e vajzave
- Ndërgjegjesim i qytetarëve për të drejtat e tyre në qasjen në shërbime
- Krijimi i mundësive për gratë për avancim profesional dhe në karrierë në institucionet publike
- Analizimi i buxhetit me perspektivë gjinore
- Organizimi i takimeve vetëdijësuese per te drejten ne trashegimi dhe prone
- Organizimi i takimeve me gra dhe vajza për informimin dhe rëndesine e pjesemarrjes se tyre në dëgjimet buxhetore

Objektivi 3: Avancimi i realizimit të të drejtave në vendimmarrje

Aktivitetet

- Ndërrmarrja e masave afirmative për sigurimin e pjesëmarrjes së barabartë gjinore në përputhje me kërkesat e ligjit për barazi gjinore në poitat vendimarrëse
- Mbajtja e aktiviteteve ndërgjegjësuese dhe vetëdijesuese mbi barazinë gjinore për grupin e grave deputete të Asamblesë Komunale
- Organizimi i debateve publike për përfaqësimin e grave në proceset e negociimit paqës dhe pajtimit

VIII. Plani i monitorimit dhe i vleresimit .

Për monitorimin dhe zbatimin e këtij plani obligohet Komuna e Mitrovicës dhe dikasteret e saj të përmendur në këtë dokument Akteret përgjegjës për zbatimin e aktiviteteve si dhe ato partnere në zbatim duhet të informojnë në mënyrë të rregullt Zyrën e Kryetarit me anë të të dhënave mbi arritjen e objektivave dhe realizimin e aktiviteteve të përcaktuara Të paktën një herë në vit Kryetari i Komunës raporton në Kuvendin e Komunës mbi progresin e arritur

Shtojca

Tabela e aktiviteteve për realizimin e planit të punës

Plani i punës: 2020-2022

I. Fusha e veprimit : fuqizimi ekonomik Objektivi qendror: Krijimi i mundësive të barabarta për të kontribuar në dhe përfituar nga zhvillimi ekonomik gjithëpërfshirës dhe përmirësimin e mirëqenies sociale									
Nr.	Veprimi/Aktiviteti	Afati i fundit	Buxheti			Burimi i financimit	Institucioni udhëheqës dhe mbështetës	Produkti rezultati	Referenc a në dokumen te
			Viti 2020	Viti 2021	Viti 2022				
1.1	Aktivite promovuese për të drejtat ne pune dhe pushimi i lehonise (fushata vetëdijësuese dhe kampanja informuese per publikun e gjere me theks te vecant grate te cilat jane te gatshme per pune ,ketu mund te hyjne edhe trajnimet dhe sesionet informuese)	2020-2022	2.000	2.000	2.000	Buxheti	Zyra për Barazi Gjinore Zyra për informim OJQ-të lokale	Publiku i informuar pergjate 5 fushatave informuese	PKBGJ dhe strategjia sektoriale e MPMS per 2018-2020 Ligji per barazi gjinore
1.2.	Subvencionimi i pagesës për kopshtet e fëmijëve të nënave vetë-ushqyese, përfituese të skemave sociale	2020-2022	1.200	1.200	1.200	Buxheti	DPMS , Drejtoria për Arsim	6 fëmijë të subvencionuar nga 2 në vit-2	Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë 2017-2021
1.3	Analiza dhe vlerësimi i koston financiare për subvencionimin e pagesës për edukimin parashkollor, për fëmijët nga familjet që janë në skema sociale	2021	0	2.000	0	Buxheti	Drejtoria për Arsim	Vlerësimi i finalizuar vetem per komunen e Mitrovices	Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë 2017-2021

1.4	Trajnimi i përfituesve të kategorive sociale dhe angazhimi i tyre në programet e punësimit	I vazhdueshëm	0	0	0	Nuk ka kosto shtesë	DPMS ,QPS-të MPMS	Përfshirja e përfituesve të Ndihmës Sociale në programe të punësimit	Strategjia Sektoriale e MPMS-së 2018-2022 PKBGJ
1.5	Përmisimi i shërbimeve të ofruara në qendrën rezidenciale dhe ditore për personat e moshuar dhe pa përkujdesje familjare	2021	0	0	0	Nuk ka kosto shtesë Kosto e përfshirë në Planin e Veprimet të Strategjisë Sektoriale të MPMS-së 2018-2021	DPMS MPMS	ofrimi i shërbimeve të mira për personat e moshuar dhe pa përkujdesje familjare	Strategjia Sektoriale e MPMS-së 2018-2022
1.6	Ndermarrja e masave afirmative në punësim	2021-2022	0	0	0	Nuk ka kosto shtesë	Zyra ligjore e Komunes , Kuvendi Komunal	2 masa afirmative në vitin 2021 dhe 2022	PKBGJ, LBGJ
1.7	Ngritja e kapaciteteve për integrimin gjinor në politika publike, në nivelin lokal	2021-2022	0	2.000	2.000	Buxheti komunal dhe donatorët	ZBGJ, Kuvendi Komunal	Se paku 35 asambleist/e komunale në 2 vite të trjnuar	PKBGJ, LBGJ
1.8	Monitorimi i politikave komunale me qëllim të përfshirjes së prespektivës gjinore	I vazhdueshëm	0	0	0	Nuk ka kosto shtesë	Zyrtaret komunal për hartimin e politikave dhe ZBGJ	Raportet e monitorimit	LBGJ
1.9	Integrimi i perspektivës gjinore/ marrja e masave afirmative për ndarjen e banesave sociale	2021	0	0	0	Nuk ka kosto shtesë	DPMS	Se paku një masë e tilla e ndermarre dhe 1-2 banesa të ndara	PKBGJ
1.10	Promovimi i grave të suksesshme në profesione joti pike si	2020-2022	1.000	1.500	1.500	Buxheti komunal	Drejtoria për Bujqësi dhe ajo	Se paku një aktivitet promovues në vit	PKBGJ LBGJ

	bujqesi,ndermarresi etj						për Financa		
1.11	Përfshirja e perspektivës gjinore në panairët ekzistuese	2022	0	0	0	Nuk ka kosto shtesë	Drejtoria për Bujqësi	Panairët me perspektivë gjinore	LBGJ
1.12	informimi i grave për mundësitë e përfitimit nga Programet Komunale	2020	120.00	0	0	Buxheti komunal	Zyra për informim, Drejtoria për bujqësi,OJQte lokale dhe organizatat nderkombetare	Se paku nje takim informues i mbajtur	LBGJ
1.13	Organizimi i punetoreve nje ditore me grate e interesuara të fillojnë një biznes dhe grate sipërmarrëse	2020	250.00	0	0	Buxheti komunal	Zyra për informim, Drejtoria për zhvillim ekonomik dhe financa ,OJQ lokale	Nje punetori e organizuar me 25 pjesemarrës	PKBGJ
	Buxheti ne total per vite		4.570.00	8.700.00	6.700.00				
	<i>Buxheti total per tre vite</i>		19.970.00						
.2	Fusha e veprimt : Avancimi i barazisë gjinore Objektivi qendror: Avancimi i barazisë gjinore dhe zhdukja e pabarazive dhe stereotipeve gjinore								
Nr.	Veprimi/Aktiviteti	Afati i fundit	Buxheti			Burimi i financimit	Institucioni udhëheqës dhe mbështetës	Produkti (Output)	Referencat në dokumente
			Viti 2020	Viti 2021	Viti 2022				
2.1	Aktivitetet vetedijësuese për nevojën për një grup të arsimuar	2020	0	0	1.000	Buxheti komunal	Drejtoria për arsim ZBGJ	Broshura të shtypura ,billborde	LBGJ PKBGJ
2.2	Ndergjegjësimi i qytetarëve për të drejtat e tyre në qasjen në shërbime	2020-2022	1.000	1.000	1.400	Buxheti komunal	Drejtoria për administratë ZBGJ	Se paku nje fushate e realizuar ne vit	Ligji për Barazi Gjinore
2.3	Krijimi i mundësive për gratë për	2021 -	0	0	0	Nuk ka	Zyra ligjore	Se paku nje politik	Ligji për

	avancim profesional dhe në karrierë në institucionet publike komunale	2022					kosto shtesë	ZBGJ	komunale e hartuar per mbrojtjen nga diskriminimi dhe ngacmimi seksual	Mrojtjen nga diskriminimi
2.4	Analiza të buxhetit me perspektivë gjinore	2021-2022	0	0	200.00	Buxheti Komunal	Drejtoria per financa ,ZBGJ	Analiza e publikuar	Ligji për Barazi Gjinore	
2.5	Organizimi i takimeve vetëdijësuese për të drejtën në trashëgimi dhe pronë	2020-2022	200.00	200.00	200.00	Buxheti Financimi i Donatorëve	Drejtoria per kadaster ZBGJ	3 takime nga nje takim ne vit	Ligji për Barazi Gjinore	
2.6	Organizimi i takimeve vetedijesuese me gra dhe vajza per informimin dhe rendesine e pjesemarrjes se tyre ne degjimet buxhetore dhe planet e komunes	2021-2022	0	200.00	200.00	Buxheti Komunal	Zyra per Informim ZBGJ Drejtoria per financa	Rritja e nr te grave si pjesemarrrese ne planifikimin e projekteve kapitale te komunes	Ligji për Barazi Gjinore	
	Totali i buxhetit per vite		1.200.00	1.400.00	3.000.00					
	Buxheti total	5.600.00								
3	Fusha e veprimit : vendimarrja									
	Objektivi qendror: Avancimi i realizimit të të drejtave në vendimarrje									
Nr.	Veprimi	Afati i fundit	Buxheti			Burimi i financimit	Institucioni udhëheqës dhe mbështetës	Produkti (Output)	Referenca në dokumente	
			Viti 2020	Viti 2021	Viti 2022					
3.1	Ndërmarrja e masave afirmative për sigurimin e pjesëmarrjes së barabartë gjinore në përputhje me kërkesat e Ligjit për Barazi Gjinore në pozitave vendimarrëse	I vazhdim	200.00	200.00	200.00	Buxheti komunal Financimi i donatorëve	Kuvendi Komunal	Numri i vendimeve të masave afirmative të ndërmarra	Ligji për Barazi Gjinore i Kosovës	
3.2	Mbajtja e aktiviteteve	I		1000.0	1000.0	Buxheti	ZBGJ , Gratë	Numri i takimeve të	Ligji për	

	ndërgjegjësuese dhe vetëdijësuese mbi barazinë gjinore për grupin e grave deputete të asambleve komunale dhe nivelit qendror	vazhd ueshë m	1000.00	0	00	komunal Financimi i donatorëve	asambleiste Shoqëria civile, donatorë	mbajtura	Barazi Gjinore i Kosovës
3.3	Organizimi i debateve politike per perfaqesimin e grave ne proceset e paqes dhe pajtimit	I vazhd ueshë m			200.0 0	Buxheti komunal Financimi i donatorëve	ZBGJ, Gratë asambleiste Shoqëria civile, donatorë	Arritja e bashkepunimit ne mes te grave te mitrovices se jugut dhe veriut per proceset e negociimit te paqes dhe pajtimit	Ligji për Barazi Gjinore i Kosovës
	Totali i buxhetit për vite		200.00	200.00	1400.0 0				
	Buxheti total për tre vite	4200.00							
	Buxheti total i plani të punës	29.770.00							

Plani i punës për barazi gjinore 2020-2023 në Komunën e Mitrovicës, është hartuar me iniciativë të grupit jo-formal të grave anëtare të Kuvendit të Komunës së Mitrovicës në bashkëpunim me zyrtaren për Barazi Gjinore në Komunën e Mitrovicës. Ky bashkëpunim është inicuar në kuadër të projektit “Përtej barazisë numerike: Fuqizimi i grave anëtare të Kuvendeve të Komunave në qeverisje lokale”, i cili mbështetet në kuadër të Programit Angazhimi për Barazi – E4E, i financuar nga Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar – USAID dhe mbështetur nga Qendra e Trajnimeve dhe Burimeve për Avokim – ATRC.

Mitrovicë

Dorëzohet:

- 1 x 1 Kryesuesit të Kuvendit
- 1 x 1 MAPL
- 1 x 1 Arkivit
- Kopje:** Kryetarit të Komunës



Kryesuesi i Kuvendit
Sanfër KAMBERI